



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilazur: 06.05.2014

Nr. i aktit	Numri i protokollit	Shprehja e Paringut	Vlera Vrednost
01-013/600			



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Vitia

Në bazë të nenit 12,2 pika d, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 ( Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, nenit 3, pika 3.1 të U.A. Nr. 2008/10 për Organizimin dhe funksionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna si dhe nenit 36.2 pika d, të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, aprovon këtë:

### V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMITETEVE KONSULTATIVE

#### Neni 1

Me këtë Vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë themelon komitetet konsultative, si në vijim:

- Komiteti për Zhvillim Ekonomik
- Komiteti për Personat me Aftësi të Kufizuar

#### Neni 2

Anëtarësimi në komitete konsultative do të bëhet nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të cilët janë ekspertë të fushave përkatëse.

#### Neni 3

Kuvendi i Komunës shpall konkurs publik për anëtarësimin në komitetet konsultative , duke përcaktuar kriteret për konkurim.

#### Neni 4

Kuvendi i Komunës themelon panelin përzgjedhës për zgjedhjen e anëtarëve të komiteteve konsultative, në këtë përbërje:

1. Vjollca Kadolli – kryetare
2. Bekim Azizi – anëtar
3. Majlinda Ostrogllava - anëtare

#### Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

#### Neni 6

Ky Vendim, hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës

Kryesuesi i Kuvendit  
Naim PIRA

